



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 prill 2016  
Nr. ref.:RK935/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin nr. KI62/15**

Parashtrues

**Xhavit Shala**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit,  
Ac. nr. 4332/2012, të 26 nëntorit 2014**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Xhavit Shala nga fshati Mushtisht, komuna e Suharekës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga z. Ismet Islami, avokat në Suharekë.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi konteston Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), Ac. nr. 4332/2012, të 26 nëntorit 2014, i cili i ishte dorëzuar atij më 11 dhjetor 2014.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur neni 46 [Mbrojtja e Pronës] i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

5. Më 15 maj 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 29 qershor 2015, Kryetarja e Gjykatës, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Bekim Sejdiu.
7. Më 24 korrik 2015, Gjykata e njoftoi parashtruesin dhe Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 29 korrik 2015, Gjykata Themelore në Prizren e njoftoi Gjykatën se kur parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar vendimi i kontestuar.
9. Më 28 janar 2016, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë dokumente shtesë të nevojshme për të plotësuar kërkesën e tij.
10. Më 15 shkurt 2016, parashtruesi i dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
11. Më 15 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

12. Më 26 tetor 2005, Gjykata Komunale në Suharekë (Aktgjykimi C. nr. 55/05) e aprovoi padinë e parashtruesit dhe e obligoi Komunën e Suharekës që t'ia kompensojë parashtruesit të kërkesës një shumë për tokën e shpronësuar. Komuna e Suharekës parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër vendimit të 26 tetorit 2006.
13. Më 22 shtator 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktvendimi Ec. nr. 510/05), anuloi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale të 26 tetorit 2006 dhe e ktheu rastin për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
14. Më 17 shtator 2010, Gjykata Komunale në Suharekë (Aktgjykimi C. nr. 285/2006), e refuzoi si të pabazuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës.
15. Më 5 korrik 2012, Gjykata e Qarkut në Prizren (Aktgjykimi Ac. nr. 598/2010) e refuzoi ankesën e parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të 17 shtatorit 2010.
16. Më 16 tetor 2012, Gjykata Komunale në Suharekë e refuzoi kërkesën për revizion të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës. Parashtruesi parashtroi ankesë.
17. Më 26 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktvendimi Ac. nr. 4332/2012) e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale të 16 tetorit 2012.

## **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

18. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit ishte shkelur e drejta e tij për mbrojtje të pronës.
19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit e privoi atë nga e drejta e tij për mbrojtje të pronës, sepse sipas tij ajo *“nuk e njoftoi parashtruesin lidhur me rregullat që janë paraparë në dispozitat e nenit 218 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e Apelit theksoi se kërkesa për revizion është e palejuar dhe se në shkresat e lëndës vlera e kontestit në padinë e paditësit është caktuar në shumën prej 100 € dhe revizioni nuk është i lejuar dhe se është dashtur të ceket vlera e kontekstit në shumën prej 3.000 € dhe revizioni është hedhur poshtë si i palejuar që d.m.th që Gjykata është dashur ta njoftojë palën paditëse lidhur me pasojat e kontestit të caktuar në shumën prej 100 € e jo ta hedhë poshtë revizionin si të palejuar”*.

## **Pranueshmëria e kërkesës**

20. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
21. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:

*“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
22. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...”.*
23. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

*“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:  
...  
(c) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit”.*
24. Gjykata vëren se Aktvendimi, Ac. nr. 4332/2012, i Gjykatës së Apelit është nxjerrë më 26 nëntor 2014 dhe i është dorëzuar parashtruesit më 11 dhjetor 2014, ndërsa parashtruesi e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatë pas më shumë se 5 (pesë) muaj, përkatësisht më 15 maj 2015.
25. Rrjedhimisht, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë pas skadimit të 4 (katër) muajve, që nga dita kur Aktvendimi i Gjykatës së Apelit i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, është të promovojë siguri ligjore, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje të Kushtetutës të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme si dhe vendimet e kaluara të mos jenë vazhdimisht të hapura për kontestim (Shih rastin *O'LOUGHLIN dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 23274/04, GJEDNJ, Vendimi i 25 gushtit 2005).
27. Nga kjo rrjedh, se kërkesa është dorëzuar jashtë afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe prandaj, është e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, njëzëri

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Robert Carolan

**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi

